



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E POSAÇME E SHKALLËS SË PARË
PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR

NJOFTIM PËR MEDIAT

1. Kërkuesi **Ermal Nika** me datë **06.09.2024** ka paraqitur pranë Gjykatës kërkesën me objekt: Parashkrimi i ekzekutimit të vendimit nr. 12, datë 18.12.2008 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda Tiranë, pasi kanë kaluar 10 vjet nga data e vendimit të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, më datë 05.03.2014.

2. Në përfundim të gjyqimit, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korruptionin dhe Krimin e Organizuar me trup gjykues të përbërë nga gjyqtari Erjon Bani, bazuar në nenet 379, 470-480, të K.Pr.Penale dhe në nenin 68 të K.Penal, me vendimin Nr. **517**, datë **05.11.2024**, vendosi:

1. Pranimin e kërkesës së kërkuesit (të dënuarit) **Ermal Foto Nika**.
2. Deklarimin e shuar të dënimit dhënë ndaj të dënuarit **Ermal Foto Nika** me vendimin Nr. 12 datë 18.02.2008 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, Tiranë, për të cilin është vendosur ndryshimi me vendimin Nr. 32, datë 22.05.2008 të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda, Tiranë, i cili është lënë në fuqi me vendimin Nr. 64, datë 05.03.2014 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, për shkak të parashkrimit të ekzekutimit të dënimit, në kuptim të nenit 68/b të Kodit Penal.
3. Ngarkohet Prokuroria e Posaçme kundër Korruptionit dhe Krimit të Organizuar për ekzekutimin e këtij vendimi.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim, në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korruptionin dhe Krimin e Organizuar, brënda 15 ditëve, afat i cili fillon nga dita e nesërme e njoftimit të vendimit.

Tiranë, më datë 05.11.2024

Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korruptionin dhe Krimin e Organizuar